

LIGJ
Nr. 144/2015

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 6, “Mbrotjta e detyrueshme”, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 9, “Llojet e kontributeve për t’u paguar”, pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, për-fshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, si dhe kriteret e përcaktimit të saj, nga paga minimale deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2016.

Miratuar në datën 17.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9396 , datë 7.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani